



Republika e Kosovës
Qeveria - Vlada – Government

***Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - Ministarstvo Industrije,
Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade***

Kabineti i Ministres - Kabinet Ministra - Cabinet of the Minister

01 Ref. Nr.36

Datë: 09.08.2021

Ministria e Industrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në mbështetje të nenit 92 paragrafit 4 dhe nenit 93 paragrafit 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 10, 11, dhe 17 të Ligjit Nr. 06/L-113 Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019), nenit 28, paragrafit 1, paragrafit 6, nën paragrafit 6.1 dhe paragrafit 10 të Ligjit Nr. 04/L-240 për Masat Antidamping dhe Masat Kundërbalancuese, si dhe Shtojcës 12 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive merr:

V E N D I M

1. Aprovohet rekomandimi i Departamentit të Tregtisë për hapjen e hetimit zyrtar për importin e bllokave standard me dimensione 19x19x25 të importuar nga Serbia.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Të gjeturat e analizës preliminare të kryera nga Departamenti i Tregtisë si pjesë e rivlerësimit të bërë para skadimit të masës mbrojtëse antidamping prej 0.02 € për bllokat standard 19x19x25 dhe analizës aktuale tregojnë se ka elemente se importi i këtyre produkteve nga Serbia po vazhdon të shkaktojë dëme materiale përmes çmimeve damping ndaj industrisë së prodhuesve vendor të materialit ndërtimor nga argjila.

Prandaj, duke analizuar këtë sektor para dhe pas shfuqizimit të masës mbrojtëse antidamping, të dhënat e dala nga hulumtimi preliminar i bërë nga Departamenti i Tregtisë në bashkëpunim me Komisionin për Vlerësimin e Detyrimeve të Veçanta në Importe dhe takimit me Shoqatën e Prodhuesve të Materialit Ndërtimor nga Argjila tregojnë për një tendencë të dëmtimit të prodhimit vendor nga produktet e importuara nga Serbia, në drejtim të çmimeve damping. Duke u bazuar në ligjin për Masat Antidamping dhe Masat Kundërbalancuese përkatësisht

nenit 28 Departamenti i Tregtisë në konsultim me Komisionin për Vlerësimin e Detyrimeve të Veçanta në Importe rekomandon marrjen e vendimit për hapjen e hetimit zyrtar për importin e bllokave standard me dimensione 19x19x25 nga Serbia me dyshimet se një import i tillë i bllokave të importuar nga Serbia në Kosovë po vazhdon të shitet me çmime më të ulëta se çmimi i tyre në tregun e brendshëm në Serbi dhe rrjedhimisht një import i tillë rrezikon prodhimin vendor për shkak të çmimeve jo reale dhe të dampuara.



Rozeta HAJDARI

Rozeta Hajdari
Ministër e Ministrisë së Industrisë,
Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Vendimi i dërgohet:

- Doganës së Kosovës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Anëtarëve të Komisionit për Vlerësimin e Detyrimeve të Veçanta të Importit;
- Departamentit të Tregtisë;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit.